REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës:	2019:206535
Datë:	11.03.2020
Numri i dokumentit:	00935229

C.nr.2961/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Dardan Kadolli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.A.nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Bajram Azemi nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve "K. e R." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson V.R., me objekt të padisë kompensim i dëmit, në seancën e shqyrtimit përgatitor publike, me datë 11.03.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses A.A.nga Prishtina, ashtu që detyrohet e paditura KS "K. e R." me seli në Prishtinë që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e datës 30.07.2016 t'ia kompensoj shumës në lartësi prej 259.60€, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 243.00€, me kamatë 8 për qind nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor pas pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së tij, pranë kësaj gjykate, me datë 02.12.2016, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt të padisë kompensim i dëmit. Në padi ka theksuar se, me datë 30.07.2016, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit ndërmjet paditëses, dhe ngasëses së një automjeti tjetër që ishte prapa saj. Ky aksident është shkaktuar se pasojë i fajit të vozitësit që ishte prapa sajë, me ç'rast duke dalë nga parkingu e godet automjetin. Në padi është theksuar se si pasojë e këtij aksidenti, automjeti i paditësit i tipit "BMË X6" është dëmtuar në vlerë prejv259.60€.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Në përgjigjen në padi, përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës e ka kontestuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, për sa i përket lartësisë së saj, ngase shumat e cekura në padi, janë paushallë dhe shumë të larta. Kurse në seancën e shqyrtimit kryesor, i autorizuari i të paditurës ka pohuar kërkesëpadinë.

2019:206536

Për shpenzime të procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të padituës, konstatoi se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët mund të disponojnë lirshëm, në kuptim të nenit 148 paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se "*në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejmë, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)*" – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2961/16 datë 11.03.2020

Gjyqtari

Dardan Kadolli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkaku se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit, në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.